



**Udhëzues për:  
Vëzhgimin e zgjedhjeve dhe si  
mund të ndihmohen personat  
me aftësi të kufizuara të  
marrin pjesë në zgjedhje**



**Informacione të thjeshta për  
t'u kuptuar**



**Udhëzues për:  
Vëzhgimin e zgjedhjeve dhe si  
mund të ndihmohen personat  
me aftësi të kufizuara të  
marrin pjesë në zgjedhje**

**Informacione të thjeshta për  
t'u kuptuar**



Ky udhëzues është botuar fillimisht në vitin 2017 nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) si:

**Udhëzuesi për vëzhgimin dhe promovimin e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara në zgjedhje.**

Ky version i thjeshtë për t'u kuptuar është përgatitur si pjesë e Projektit të Mbështetjes për Zgjedhjet në Ballkanin Perëndimor, financuar nga Bashkimi Evropian dhe Agjencia Austriake për Zhvillim. Ju lutemi, referojuni botimit fillestar si version zyrtar dhe përfundimtar.

Ky libër është në përputhje me standardet evropiane për ta bërë informacionin të thjeshtë për t'u lexuar dhe për t'u kuptuar.

Mësoni më shumë, duke vizituar: [www.inclusion-europe.eu/easy-to-read/](http://www.inclusion-europe.eu/easy-to-read/)

# Përmbajtja

# Faqja

**Hyrje** **4**

---

**KDPAK dhe dokumente  
të tjera të rëndësishme  
ndërkombëtare** **14**

---

**Pengesat ndaj pjesëmarrjes  
në zgjedhje** **26**

---

**Fazat e ndryshme  
të zgjedhjeve** **31**

---

**Puna e ODIHR-it** **47**

---

**Kontaktet** **53**

**Hyrje**



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë quhet shkurt **OSBE**.

Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut quhet shkurt **ODIHR**.

ODIHR-i është pjesë e OSBE-së.



ODIHR-i mendon se është e rëndësishme që personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të marrin pjesë në zgjedhje.

*Vëzhguesit gjatë procesit të votimit*



Personat që punojnë **si vëzhgues zgjedhesh të ODIHR-it** kontrollojnë nëse zgjedhjet zhvillohen në përputhje me **ligjet ndërkombëtare**.

**Ligjet ndërkombëtare** janë rregulla mes shteteve të ndryshme që duhet të respektohen.



**Vëzhguesit e zgjedhjeve të ODIHR-it** kontrollojnë nëse personat me aftësi të kufizuara kanë mundësi të marrin pjesë në zgjedhje.



Ky libërth na tregon për gjërat që i ndihmojnë personat me aftësi të kufizuara që të marrin pjesë në zgjedhje.



Ky libërth u tregon vëzhguesve të ODIHR-it se si të kontrollojnë nëse personat me aftësi të kufizuara e kanë mundësinë të marrin pjesë në zgjedhje.



### Aftësia e kufizuar

Rreth 1 miliardë persona në botë kanë një **aftësi të kufizuar**.

Personat me **aftësi të kufizuara** kanë nevoja të ndryshme.



Një person me një **aftësi të kufizuar fizike** e ka të vështirë të lëvizë.

Një person me aftësi të kufizuar fizike mund të përdorë karrige me rrota.



Një person me **aftësi të kufizuar shqisore** mund të ketë vështirësi me shikimin.

Një person me **aftësi të kufizuar shqisore** mund të ketë vështirësi me dëgjimin.



Një person me **aftësi të kufizuar psiko-sociale** mund të mos ndihet mirë.

Kjo do të thotë se këta persona mund të ndihen të shqetësuar ose të mërzitur.



Një person me **aftësi të kufizuar intelektuale** mund ta ketë të vështirë të mësojë gjëra të reja.



Personat me aftësi të kufizuara janë grup **i larmishëm**.

**Larmi** do të thotë që njerëzit janë të ndryshëm nga njëri-tjetri.





Personat me aftësi të kufizuara kanë nevoja të ndryshme.

Personat me aftësi të kufizuara nuk mendojnë të gjithë njësoj.

Personat me aftësi të kufizuara kanë ide të ndryshme.



Personat me aftësi të kufizuara kanë **përparësi** të ndryshme.

**Përparësitë** janë gjërat më të rëndësishme për një person.



Duhet të kuptojmë se personat me aftësi të kufizuara janë të ndryshëm.

Kjo na ndihmon të sigurohemi që personat me aftësi të kufizuara të përfshihen si duhet në zgjedhje.



Bota ndryshon vazhdimisht.

Njerëzit po mësojnë mënyra të reja se si të mendojnë për gjërat.

Në të kaluarën, flisnim se si t'i ndihmonim personat me aftësi të kufizuara me mirësi dhe bamirësi.



Tashmë e dimë se personat me aftësi të kufizuara kanë të njëjtat të drejta si të gjithë.

Këto quhen **të drejtat e njeriut**.

Është një dokument që quhet **Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara**.



Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara quhet shkurt **KDPAK**.

**KDPAK-ja** është një dokument ligjor për të drejtat e njeriut të personave me aftësi të kufizuara.

KDPAK-ja na thotë se personat me aftësi të kufizuara kanë të njëjtat të drejta si gjithë të tjerët.



Ajo pjesë e KDPAK-së që quhet **Neni 29** thotë se personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të marrin pjesë në politikë dhe në zgjedhje.



Ajo pjesë e KDPAK-së që quhet **Neni 12** thotë që të pranojmë vendimet që marrin personat me aftësi të kufizuara.

**Neni 12** thotë që personat me aftësi të kufizuara duhet të ndihmohen për të marrë vendime.



Marrja e vendimeve me ndihmë quhet **vendimmarrje e mbështetur.**

Vëzhguesit gjatë procesit të votimit



**Vëzhguesit e zgjedhjeve të ODIHR-it** duhet të kontrollojnë nëse shtetet zbatojnë rregullat e KDPAK-së.



Një person me aftësi të kufizuara mund të marrë pjesë në zgjedhje në shumë mënyra:

Në politikë mund të marrësh pjesë kur je **kandidat në zgjedhje.**

**Kandidat në zgjedhje** është një person që dëshiron të punojë si politikan. Një kandidat në zgjedhje dëshiron që njerëzit të votojnë për të.



Në politikë mund të marrësh pjesë kur punon në një **fushatë zgjedhore.**

**Fushata zgjedhore** është koha para zgjedhjeve, kur politikanët bëjnë thirrje që njerëzit të votojnë për ta.



Në zgjedhje mund të marrësh pjesë kur **voton**.

**Ky libërth ka katër pjesë.**



**Kapitulli 1** flet për KDPAK-në dhe për dokumente të tjera të rëndësishme nga bota.



**Kapitulli 2** flet për **pengesat** me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara në zgjedhje.

**Pengesat** janë gjërat që ua vështirësojnë pjesëmarrjen në zgjedhje personave me aftësi të kufizuara.

Kapitulli 2 flet se si të ndihmojmë kur ka pengesa.



**Kapitulli 3** flet për çdo fazë të zgjedhjeve.

Kapitulli 3 flet edhe për gjërat që duhet të kontrollojnë vëzhguesit e zgjedhjeve të ODIHR-it në çdo fazë të zgjedhjeve.



**Kapitulli 4** flet për mënyrat e ndryshme se si mund t'i ndjekin zgjedhjet vëzhguesit e zgjedhjeve të ODIHR-it.

Kapitulli 4 flet edhe për mënyrat se si ODIHR-i ndihmon qeveritë.

# **Kapitulli 1**

## **KDPAK-ja dhe dokumente të tjera të rëndësishme ndërkombëtare**





Ndër vite, janë shkruar shumë dokumente të rëndësishme për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në politikë.



Disa prej këtyre dokumenteve janë ide dhe plane.

Disa prej këtyre dokumenteve janë **dokumente ligjore**.

**Dokumentet ligjore** flasin për rregullat që duhet të ndjekim.



KDPAK-ja ka shumë informacione për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në jetën e përditshme dhe në politikë.



OSBE-ja thotë se **demokracia pluraliste** është mënyra më e mirë për t'u siguruar demokraci dhe drejtësi të gjitha grupeve.

**Demokracia pluraliste** do të thotë që grupe të ndryshme njerëzish të jenë të përfaqësuar në politikë dhe në diskutimet publike.






Vite më parë, personave me **aftësi të kufizuara intelektuale** mund t'u hiqej e drejta e votës.



KDPAK-ja thotë se ky është **diskriminim**.

**Diskriminim** është kur një person ose një grup personash nuk trajtohen me drejtësi.

KDPAK-ja thotë se personat me aftësi të kufizuara mund të marrin pjesë në të gjitha fazat e zgjedhjeve, pa asnjë diskriminim.



KDPAK-ja thotë se është e rëndësishme që të mblidhen informacione për personat me aftësi të kufizuara.

Ky informacion mund të përdoret për të marrë vendime të mira.

KDPAK-ja thotë se ky informacion duhet të organizohet në pjesë të ndryshme.

Pjesët e ndryshme të informacionit na tregojnë për lloje të ndryshme personash me aftësi të kufizuara.

Pjesët e ndryshme të informacionit na tregojnë mënyrat më të mira për t'i ndihmuar personat me aftësi të kufizuara që të marrin pjesë në politikë dhe në zgjedhje.



KDPAK-ja thotë se është e rëndësishme të flitet me personat me aftësi të kufizuara për ligjet dhe politikat për aftësinë e kufizuar.



Është e rëndësishme të merren mendimet e personave me aftësi të kufizuara për këto ligje dhe politika.



KDPAK-ja thotë se personat me aftësi të kufizuara duhet të kenë mundësi të përdorin të gjitha vendet dhe shërbimet publike njëjloj si personat e tjerë.

Kjo quhet **aksesueshmëri**.



KDPAK-ja thotë se informacionet duhet të jepen në një mënyrë që të gjenden dhe të kuptohen lehtë nga njerëzit.

Edhe kjo quhet **aksesueshmëri**.



**Informacionet audio** janë informacionet që merren përmes dëgjimit.

Podcast-et janë një lloj informacioni audio.



**Informacionet vizuale** janë informacionet që mund të shihen.

Posterat janë një lloj informacioni që mund të shihen.



**Informacionet me prekje** janë informacione që mund të merren përmes prekjes.

Braille është një lloj informacioni që lexohet përmes shqisës së prekjes.



Tekstet me shkronja të mëdha i bëjnë informacionet vizuale më të aksesueshme.

**Informacione të lehta për t'u kuptuar** janë informacionet që shkruhen me një gjuhë të thjeshtë.

Informacioni i lehtë për tu kuptuar përmban imazhe.



**Informacionet audio-vizuale përmbajnë informacione që mund të dëgjohen dhe mund të shihen në të njëjtën kohë.**

Videot janë një lloj informacioni audio-vizual.



Informacionet duhet të jepen në vende të aksesueshme.



Informacionet mund të vendosen në internet, në mënyrë që të mund t'i marrin edhe personat që nuk mund të udhëtojnë.



KDPAK-ja thotë se:

- Informacioni
- Shërbimet
- Vendet dhe
- Produktet

duhet të përgatiten sipas një **dizajni universal**.

**Dizajn universal** do të thotë që ambientet të organizohen në mënyrë të tillë që njerëzit të mund t'i përdorin dhe t'i kuptojnë gjërat.



Ndonjëherë, ka persona që mund të kenë edhe nevoja të tjera.

Këto nevoja nënkuptojnë që informacionet, produktet, vendet ose shërbimet të ndryshohen për ata persona.



Këto ndryshime quhen **përshtatje të arsyeshme**.

#### **Përshtatje të arsyeshme**

janë ndryshimet që u bëhen informacioneve, produkteve, shërbimeve ose vendeve, në mënyrë që të përdoren nga të gjithë njerëzit.



Ajo pjesë e KDPAK-së që quhet neni 29 flet për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në politikë dhe në zgjedhje.

Neni 29 flet për të dhënë informacione të lehta për t'u kuptuar në çdo fazë të zgjedhjeve.

Neni 29 thotë se **qendrat e votimit** duhet të jenë të aksesueshme për përdoruesit e karrigeve me rrota.



**Qendër votimi** është vendi ku një person shkon të votojë në zgjedhje.





KDPAK-ja thotë se më e mira është që personat me aftësi të kufizuara të votojnë në qendrat e votimit së bashku me të gjithë personat e tjerë.

Kjo ndihmon në sigurimin e fshehtësisë së votës së tyre.

Vota e fshehtë është pjesë e rëndësishme e demokracisë.



Neni 29 thotë se personat që kanë vështirësi me shikimin duhet të jenë në gjendje të votojnë në qendrën e votimit, duke përdorur një **pajisje ndihmëse në votim**.

**Pajisjet ndihmëse** në votim janë disa gjëra që e bëjnë të mundur ose më të lehtë votimin e një personi me aftësi të kufizuara.




Neni 29 thotë gjithashtu se personat me aftësi të kufizuara mund të mbështeten për të votuar në një qendër votimi nga një person që ata e zgjedhin vetë.



Takimet politike duhet të zhvillohen në vende të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuara.



Kjo do të thotë gjithashtu që njerëzit të kenë mundësi të marrin pjesë në takime edhe nëpërmjet internetit.



Informacionet në takimet politike duhet të jenë të aksesueshme, në mënyrë që personat me aftësi të kufizuara të mund t'i kuptojnë ato.



Informacionet që japin partitë politike dhe kandidatët duhet të jenë të aksesueshme, në mënyrë që personat me aftësi të kufizuara të mund t'i kuptojnë.



Kur personat me aftësi të kufizuara i kuptojnë informacionet e ndryshme për politikën, ata mund të marrin vendime në mënyrë të informuar.

**STEREOTYPE**

Ndonjëherë, njerëzit mendojnë se personat me aftësi të kufizuara nuk janë të interesuar për zgjedhjet.

Ky quhet **stereotip**.

**Stereotipet** janë besime për grupe të caktuara njerëzish.

Stereotipet shpesh mund të jenë të gabuara dhe të dëmshme për këto grupe.



KDPAK-ja dëshiron të garantojë që personat me aftësi të kufizuara të mos trajtohen në këtë mënyrë.

KDPAK-ja dëshiron që media ta pasqyrojë pjesëmarrjen në politikë të personave me aftësi të kufizuara.

**12**

Pjesa e KDPAK-së që quhet neni 12 flet për pranimin e vendimeve të marra nga personat me aftësi të kufizuara.

Neni 12 flet gjithashtu edhe për ndihmën që duhet t'u jepet personave me aftësi të kufizuara për të marrë vendime.



Vendimmarrja përmes kësaj ndihme quhet vendimmarrje e mbështetur.





Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut është një gjykatë që shqyrton ankesat e personave që thonë se shteti i tyre u ka hequr një ose disa të drejta të njeriut.



Shkurt, kjo gjykatë quhet GJEDNJ.

Ajo çka thotë GJEDNJ-ja ka rëndësi për të gjitha shtetet në Evropë.



GJEDNJ-ja ka gjykuar një çështje për disa persona me aftësi të kufizuara në Hungari.



Kjo çështje njihet si çështja e Kiss kundër Hungarisë (2010).



Këtyre personave u ishte hequr e drejta e votës, për shkak se kishin aftësi të kufizuara intelektuale.



GJEDNJ-ja u shpreh se asnjë personi me aftësi të kufizuara nuk mund t'i ndalohej votimi.

Sipas GJEDNJ-së, personat me aftësi të kufizuara mund të testohen për të parë nëse janë të aftë të votojnë.



Organizata të rëndësishme kanë interpretime të ndryshme për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

KDPAK-ja thotë se testimi i një personi me aftësi të kufizuara para se ai ose ajo të votojë është diskriminim.

KDPAK-ja thotë se të gjithë personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të votojnë.

KDPAK-ja nuk është dakord me GJEDNJ-në për testimin e personave me aftësi të kufizuara.

# **Kapitulli 2**

## **Pengesat për pjesëmarrjen në zgjedhje**



Është e vështirë të merret informacion për numrin e personave me aftësi të kufizuara që votojnë në zgjedhje.



Disa informacione thonë se personat me aftësi të kufizuara **nuk janë të përfaqësuar sa duhet** në të gjitha fazat e zgjedhjeve.

**Mospërfaqësim sa duhet** do të thotë se nuk ka një numër të mjaftueshëm personash me aftësi të kufizuara që marrin pjesë në zgjedhje.



Personat me aftësi të kufizuara janë të mospërfaqësuar sa duhet si:

- Zgjedhës
- Kandidatë
- Politikanë
- Vëzhgues zgjedhjesh
- Zyrtarë zgjedhjesh – politikanët që përbëjnë qeverinë
- Administratorë zgjedhjesh - personat që zhvillojnë zgjedhjet.



**STEREOTYPE**

Disa nga arsyet pse personat me aftësi të kufizuara nuk marrin pjesë në zgjedhje janë:

- Pengesat ligjore – kjo do të thotë që ligjet e një shteti ua bëjnë tepër të vështirë pjesëmarrjen në zgjedhje personave me aftësi të kufizuara.
- Stereotipet negative për personat me aftësi të kufizuara.
- Informacionet për pjesëmarrjen në zgjedhje nuk janë të aksesueshme.
- Nuk ka mbështetje të mjaftueshme për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në zgjedhje.
- Nuk zhvillohen diskutime të mjaftueshme me personat me aftësi të kufizuara.



**Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara** quhen shkurt **Organizatat PAK.**

Organizatat PAK flasin për pengesat me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara.

Vendimet dhe politikat e hartuara me Organizatat PAK janë më të dobishme për personat me aftësi të kufizuara.



**Organizatat PAK** thonë se personat me aftësi të kufizuara nuk marrin pjesë në zgjedhje për shkak të diskriminimit.

Kjo do të thotë se personat me aftësi të kufizuara janë edhe më **të përjashtuar** në shoqëri.

**Përjashtim** quhet kur dikush nuk përfshihet në diçka.





Personat me aftësi të kufizuara nuk **konsultohen** ose nuk pyeten për çështje që kanë rëndësi për ta.

**Konsultim** do të thotë që personave me aftësi të kufizuara t'u kërkohe mendimi.



**“Asgjë për ne pa ne”** është emri i një fushate.



“Asgjë për ne pa ne” është një fushatë për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në marrjen e vendimeve të rëndësishme për çështje që lidhen me aftësinë e kufizuar.



KDPAK-ja thotë se personat me aftësi të kufizuara dhe Organizatat PAK duhet të jenë pjesë e vendimmarrjes.



Gratë me aftësi të kufizuara përballen me shumë pengesa në pjesëmarrjen në zgjedhje.

Nuk ka mjaftueshëm gra me aftësi të kufizuara që marrin pjesë në politikë dhe në zgjedhje.

Gratë me aftësi të kufizuara janë një **grup i mospërfaqësuar** sa duhet në politikë.



Për temat e rëndësishme për gratë me aftësi të kufizuara nuk flitet mjaftueshëm.

Në këto tema futet aftësia e personave me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë në politikë dhe për të pasur nën kontroll jetën e tyre.

Temat e rëndësishme për gratë me aftësi të kufizuara mund të harrohen.

---

# **Kapitulli 3**

## **Fazat e ndryshme të zgjedhjeve**





Vëzhguesit e zgjedhjeve të ODIHR-it duhet të mendojnë për çështjet më të rëndësishme për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në zgjedhje.

Në këtë libërth paraqitet një listë e çështjeve më të rëndësishme për vëzhguesit në çdo fazë të zgjedhjeve.



**1. Para zgjedhjeve** - kjo është periudha para se të zhvillohen zgjedhjet.



ODIHR-i është institucion i OSBE-së.

OSBE-ja ka 57 shtete anëtare.

ODIHR-i vëzhgon zgjedhjet në këto shtete.

Vetëm disa prej shteteve të OSBE-së kanë ligje për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në zgjedhje.

Shumë shtete nuk e pranojnë se mungesa e dizajnit universal është diskriminim.

Shumë shtete nuk e pranojnë se mungesa e përshtatjeve të arsyeshme është diskriminim.



---

# 9

Vëzhguesit e zgjedhjeve të ODIHR-it duhet të kontrollojnë nëse respektohet neni 9 i KDPAK-së.

Neni 9 i KDPAK-së flet për aksesueshmërinë.



Vendet ku zhvillohen fushatat dhe votimi duhet të jenë të aksesueshme.

Disa nga gjërat e rëndësishme që duhet të kenë ato janë:

- Rampat
- Parking për automjetet e personave me aftësi të kufizuara
- Tualete të aksesueshme për përdoruesit e karrigeve me rrota
- Tabela treguese për ambientet e ndryshme.





Informacionet për zgjedhjet duhet të jenë të aksesueshme.

Para zgjedhjeve, njerëzit duhet ta dinë se çfarë mbështetje do të kenë personat me aftësi të kufizuara për të votuar.

Duhet të ketë pajisje ndihmëse dhe lehtësira për lëvizjen e tyre.

**Pajisjet ndihmëse** në votim janë gjëra që e bëjnë të mundur ose më të lehtë votimin e personave me aftësi të kufizuara. Ndihamat për lëvizshmërinë janë mjete që i ndihmojnë njerëzit për të lëvizur lehtësisht.



Neni 2 i KDPAK-së flet për mënyrat e ndryshme të komunikimit me grupe të ndryshme njerëzish.

Informacionet për zgjedhjet duhet të jenë në formate të prekshme, audio dhe vizuale.

**Informacionet me prekje** janë informacionet që mund të merren përmes prekjes.

Braille është një mënyrë e dhënies së informacionit që e bën atë të kuptueshëm përmes prekjes.



**Informacionet audio** janë informacionet që dëgjohehen.

Podcast-et janë një lloj informacioni audio.



**Informacionet vizuale** janë informacionet që mund të shihen.

Posterat janë një lloj informacioni vizual.

Tekstet me shkronja të mëdha i bëjnë informacionet vizuale më të aksesueshme.



Informacione **të lehta për t'u kuptuar** janë informacionet që shkruhen duke përdorur një gjuhë të thjeshtë.

Informacione të lehta për t'u kuptuar janë imazhet.



**Informacionet audio-vizuale** përmbajnë informacione që mund të dëgjohen dhe të shihen në të njëjtën kohë.

Videot janë një lloj informacioni audio-vizual.



Informacionet në faqet e internetit për zgjedhjet duhet të jenë sipas disa rregullave të posaçme, në mënyrë që këto faqe interneti të jenë të aksesueshme.



Vëzhguesit e ODIHR-it duhet të sigurohen që fletët e votimit të jenë të aksesueshme për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.



Neni 9 i KDPAK-së thotë se personat që punojnë për zgjedhjet duhet të trajtohen për aftësinë e kufizuar.



Personat me aftësi të kufizuara duhet të konsultohen para se të merren vendimet për çështje të aftësisë së kufizuar.

**Konsultim** me personat me aftësi të kufizuara do të thotë që të merren mendimet e tyre.



Personave me aftësi të kufizuara mund t'u duhet më shumë kohë sesa grupeve të tjera për të dhënë mendimin e tyre.





Konsultimet me personat me aftësi të kufizuara duhet të zhvillohen shpesh.

Kjo ndihmon në mbledhjen e mendimeve të personave me aftësi të kufizuara.



Organizatat PAK duhet të konsultohen për rregullat e mbajtjes së zgjedhjeve.

*Vëzhguesit gjatë procesit të votimit*



Vëzhguesit e zgjedhjeve të ODIHR-it duhet të kontrollojnë nëse janë konsultuar organizatat PAK për administrimin e zgjedhjeve.



Vëzhguesit e ODIHR-it duhet të kontrollojnë nëse shteti ku mbahen zgjedhjet ka ligje që thonë se personat me aftësi të kufizuara nuk mund të votojnë.

Në disa vende, ka ligje që thonë se personat me aftësi të kufizuara nuk mund të jenë kandidatë.



Kur personat me aftësi të kufizuara nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në zgjedhje, ata mund të ankohen zyrtarisht.



Media duhet të konsultohet me organizatat PAK.

Organizatat PAK mund t'i ndihmojnë mediat për t'u siguruar që informacionet për zgjedhjet të jenë të aksesueshme.




KDPAK-ja thotë se media duhet ta edukojë publikun për mënyrën se si votohet në zgjedhje.

Ky edukim duhet të jetë i aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara.




Vëzhguesit e ODIHR-it duhet të shohin nëse personat me aftësi të kufizuara kanë mundësi të regjistrohen për të votuar.



Është shumë e vështirë të mbledhësh informacion për personat me aftësi të kufizuara që marrin pjesë në zgjedhje.

Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtën e privatësisë.



Është e vështirë të garantosh mbështetjen më të mirë kur nuk mblidhet informacion për:

- llojet e ndryshme të aftësisë së kufizuar që kanë njerëzit
- moshën
- gjininë.



Një ide e mirë është që njerëzit të pyeten se çfarë ndihme u duhet dhe jo të pyeten për aftësinë e tyre të kufizuar.



Nuk janë të shumta shtetet e OSBE-së që u japin ndihmë personave me aftësi të kufizuara që të jenë kandidatë.


Nuk është gjithmonë e mundur që personat me aftësi të kufizuara të jenë kandidatë.





**Parti politike** quhet një grup politikanësh që punojnë së bashku, sepse kanë të njëjtat përparësi dhe ide.

Personat me aftësi të kufizuara mund të jenë anëtarë të partive politike.



Partitë politike duhet t'i bëjnë të aksesueshme informacionet për planet e tyre.



Kjo ndihmon për t'u siguruar që personat me aftësi të kufizuara të mund të marrin vendime të informuara.




Partive politike mund t'u duhet që të sigurojnë ndihmë dhe para shtesë për ta ndihmuar një person me aftësi të kufizuara që të kandidojë në zgjedhje.



Një kandidat me aftësi të kufizuara në zgjedhje mund të ketë nevojë për **akomodime të arsyeshme**, si për shembull për dikë që mund ta ndihmojë përmes gjuhës së shenjave.



**2. Dita e zgjedhjeve** – kjo është dita kur njerëzit votojnë.




KDPAK-ja thotë se zgjedhjet duhet të organizohen në mënyrë të aksesueshme.



KDPAK-ja thotë se duhet të përdoret **dizajni universal**.



Qendrat e votimit duhet të jenë të aksesueshme për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.



Informacioni për votimin duhet të jetë i aksesueshëm për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.



Vëzhguesit e zgjedhjeve të ODIHR-it duhet të shohin nëse personat me aftësi të kufizuara mund të marrin ndihmë për të votuar nëse kanë nevojë.



Materialet dhe pajisjet e votimit duhet të kenë dizajn universal.



Personat me dëmtime në shikim mund të kenë nevojë për:

- Lupë zmadhuese
- Fletë votimi me prekje
- Guida në alfabetin Braille.



Persona më aftësi të kufizuara të ndryshme mund të kenë nevojë për një person që e zgjedhin vetë që t'i ndihmojë të votojnë.

Është e rëndësishme që ky person të zgjidhet nga vetë personi me aftësi të kufizuara.



Nëse personi me aftësi të kufizuara ndihmohet të votojë nga një zyrtar i qendrës së votimit, vota e tij mund të mos jetë e fshehtë.



Vëzhguesit e zgjedhjeve të ODIHR-it duhet të kontrollojnë se çfarë thotë ligji për votimin e asistuar.

Vëzhguesit e zgjedhjeve të ODIHR-it duhet të kontrollojnë nëse votimi i personit është i fshehtë.



KDPAK-ja thotë se më e mira është që personat me aftësi të kufizuara të votojnë në qendrat e votimit si të tjerët.

Ndonjëherë, kjo nuk është e mundur.




Vëzhguesit e zgjedhjeve të ODIHR-it duhet të kontrollojnë nëse njerëzit mund të votojnë në mënyra të tjera.

Mënyra të tjera votimi janë votimi me postë ose votimi i lëvizshëm.



Vëzhguesit e zgjedhjeve të ODIHR-it duhet të kontrollojnë nëse këto mënyra të tjera votimi ushtrohen në mënyrën më të mirë.

---




### 3. Pas Zgjedhjeve - kjo është faza pasi njerëzit kanë votuar.

Është e rëndësishme që personat me aftësi të kufizuara t'i marrin vesh rezultatet e zgjedhjeve **në kohë reale**.



**Kohë reale** është koha kur rezultatet e zgjedhjeve jepen për publikun.



Rezultatet e zgjedhjeve duhet të jepen në formate të aksesueshme që kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.




Neni 13 i KDPAK-së thotë se gjërat duhet të jenë të drejta për personat me aftësi të kufizuara.

Vëzhguesit e ODIHR-it duhet të kontrollojnë nëse ka një mënyrë që personat me aftësi të kufizuara të bëjnë ankesë për zgjedhjet.






KDPAK-ja është e shqetësuar se personat me aftësi të kufizuara **nuk janë të përfaqësuar sa duhet** si kandidatë dhe në organizatat publike.



Është e rëndësishme të mblidhen dhe të publikohen informacione se sa persona me aftësi të kufizuara kanë qenë kandidatë në zgjedhje.

Është e rëndësishme të mblidhen dhe të publikohen informacione se sa persona me aftësi të kufizuara kanë qenë në listat e zgjedhësve.



Do të ishte e dobishme që të gjitha informacionet për personat me aftësi të kufizuara që marrin pjesë në zgjedhje të organizohen në disa pjesë.

Pjesët e ndryshme të informacionit na tregojnë për lloje të ndryshme personash me aftësi të kufizuara.


Pjesët e ndryshme të informacionit mund të përdoren për ta bërë votimin më të aksesueshëm për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

# **Kapitulli 4**

## **Puna e ODIHR-it**



Pjesëmarrja në zgjedhje e personave me aftësi të kufizuara përbën një pjesë të rëndësishme të KDPAK-së.




Është e rëndësishme të mblidhet informacion për pjesëmarrjen në zgjedhje të personave me aftësi të kufizuara.

*Observers during the voting process*



ODIHR-i dërgon vëzhgues zgjedhjesh në vende të ndryshme për të parë nëse personat me aftësi të kufizuara mund të marrin pjesë në zgjedhje.




Për të mbledhur informacione në vend, mund të ndihmojnë edhe organizatat PAK dhe vëzhguesit vendas.



Çështjet më të rëndësishme për pjesëmarrjen në zgjedhje të personave me aftësi të kufizuara janë:

- të kenë një mundësi reale për të kandiduar



- të marrin informacione të aksesueshme për zgjedhjet



- të votojnë pa pengesa



- t'i marrin rezultatet e zgjedhjeve në mënyrë të aksesueshme.



ODIHR-i dërgon një Mision për Vlerësimin e Nevojave në vend para zgjedhjeve.

**Misioni i Vlerësimit të Nevojave** kontrollon masat e marra para zgjedhjeve dhe sugjeron nëse ODIHR-i duhet të vëzhgojë zgjedhjet.

Misioni i Vlerësimit të Nevojave takohet me organizatat PAK.



Pasi i vëzhgon zgjedhjet, ODIHR-i shkruan një raport.

Në këtë raport thuhet nëse personat me aftësi të kufizuara patën mundësi të merrnin pjesë në zgjedhjet e vëzhguara nga ODIHR-i.



**Ndjekja e procesit pas zgjedhjeve** ODIHR-i vazhdon ta ndjekë procesin në shtetet ku ka vëzhguar zgjedhjet.

**Puna në vazhdimësi** e ODIHR-it përpiqet që t'i bëjë zgjedhjet më të aksesueshme.

Zgjedhjet mund të bëhen më të mira kur personat me aftësi të kufizuara janë pjesë e politikës dhe e zgjedhjeve.



Pjesëmarrja e grupeve të mospërfaqësuar sa duhet në politikë është e rëndësishme.



ODIHR-i do që t'i përfshijë grupet e mospërfaqësuar sa duhet për t'i bërë zgjedhjet më të mira.

ODIHR-i do që të sigurohet që grupet e mospërfaqësuar sa duhet të përfshihen më shumë në zgjedhjet e ardhshme.



ODIHR dëshiron që të konsultohet me organizatat PAK për t'i bërë zgjedhjet më të mira.

ODIHR-i dëshiron gjithashtu që edhe qeveritë kombëtare të konsultohen me organizatat PAK kur vjen fjala te aftësitë e kufizuara.




ODIHR-i dëshiron që qeveritë kombëtare të bëjnë atë që thotë KDPAK-ja.



**Vëzhgimi i zgjedhjeve nga ODIHR-i** i ndihmon qeveritë të mësojnë më shumë se si mund t'i ndihmojnë personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në zgjedhje.





**Vëzhgimi i zgjedhjeve nga ODIHR-i** do të thotë se zgjedhjet vëzhgohen nga ODIHR-i.

Zgjedhjet vëzhgohen për të parë nëse personave me aftësi të kufizuara u jepet mundësia të marrin pjesë në zgjedhje.



Vëzhgimi i zgjedhjeve nga ODIHR-i i ndihmon qeveritë të zbatojnë atë çka thotë KDPAK-ja për zgjedhjet.



Ky libërth ndihmon me shpjegimin e mënyrave se si garantohet pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara në zgjedhje.

# Kontakte



Për më shumë informacion, vizitoni  
**OSCE.org/ODIHR**

ose mund të merrni më shumë  
informacion, duke na kontaktuar në:



Email:  
**office@odihhr.pl**



Telefon:  
**+48 22 5200 600**



Me postë:  
**OSCE/ODIHR**  
**ul. Miodowa 10**  
**00-251 Warsaw, Poland**